REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 datë 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës________2021 të miratojë këtë:

PROPOZIM

# VENDIM
# PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

## Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.Paykos L.L.C sh.p.k, me nr. biznestit 810843955 adresa Veternik Zona Industriale -Prishtinë me pronar Armend Zeqiraj, është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës.

2.Pronat e paluajtshme të Komunës, gjenden në ZK Babush i Muhaxherëve, të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse si në tabelën në vijim:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

1.Shfrytëzimi i pronave komunale do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

2.Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara konform dispozitave ligjore.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektoratit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12, 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 20 dhe 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 datë 26.09.2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.apragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr-463-32604 të datës 30.07.2020.

Bazuar në aplikacionet dhe dokumentet e tjera përcjellëse si në shkresat e lëndës të datës 25.03.2021 ref.1-463-16492 dhe 25.03.2021 ref. 1-463-16494 të ofertuesit Paykos L.L.C sh.p.k, me nr. biznestit 810843955 adresa Veternik Zona Industriale -Prishtinë me pronar Armend Zeqiraj, është bërë hapja publike e ofertës me datë 29.03.2021 në ora $10^{00}$ nga ana e Komisionit Vlerësues dhe është vlerësuar se ofertuesi i ka plotësuar kushtet për marrjen e parcelave 00559-4 dhe 00555-2 ZK Babush i Muhaxherëve në shfrytëzim sipas Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr-463-32604 të datës 30.07.2020, dhe të Njoftimit të datës 11.03.2021 ref.Nr.1-463-463-14010, ofertuesi i lartëcekur, është përzgjedhur si shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës në afat prej 99 viteve për parcelat e cekura siç përcaktohet në nenin 1 pika 2 e këtij propozim-Vendimi.

Bazuar në raportin datë 14.04.2021 ref.15-463-19466 të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës mbi vlerësimin e ofartave të pranuara dhe të njoftimit publik Nr.1-463-14010, për dy parcelat e publikuara ka aplikuar vetëm një ofertues dhe nuk ka pasur ofertues apo të interesuar të tjerë, ndërsa sa i përket ofertës së përzgjedhur siç përcaktohet në nenin 1 pika 2 e këtij propozim-Vendimi konform dispozitave të Ligjit është respektuar afati për parashtrimin e ankesave dhe përkitazi me këtë çështje, nuk është parashtruar ndonjë ankesë kundër ofertuesit të përzgjedhur nga ana e Komisionit Vlerësues.

Prandaj bazuar në arsyet e theksuara më lartë dhe konform dispozitave ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

1Nr. 1-011-23267

Lipjan, më 12.05.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 3868 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Lipjanit** | 600371588 | / / / | | SHQIPËRIA | **1/1** | | 24.06.2016 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409059-00559-4

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 1279/2021 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 23.04.2021 - 13:46 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Babush I Muhaxherëve / Muhadžer Babuš / Babushi I Muhagjerve |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area ($m^2$) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71409059-00559-4 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 16132 | ndarje fiz. lf. 1/2016 | 23.02.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| BALKAN/BALKAN/BALKAN | | BALKAN | 23.02.2016 | |



Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 16132 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **Komuna e Lipjanit** | 600371588 | / / / | | SHQIPËRIA | 1/1 | | 24.06.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Babush i Muhagjerëve

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71409059-00555-2 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3868 |
| P-71409059-00559-4 | Parcelë / Parcela / Parcel | 16132 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1716

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 23.04.2021
Koha/ Vreme/ Time: 01:59:44
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me date 30.07. 2020,pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

# VENDIM
## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

### Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjinden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të paraqitura në tabelën si në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

### Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale jepen në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet Njoftimit publik. Pronat e cekura në nenin 1 të këtij vendimi janë publikuar brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Kryetarit të Komunës 1Nr.463-62822 datë

18.09.2019 konformë dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 si prona të lira për dhënien në shfrytëzim.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale është investimi në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Procedurën e Njoftimit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr.15- 463-32604

Lipjan, më 30. 07. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

| | |
|---|---|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVA | KOMUNA E LIPJANIT<br>OPŠTINA LIPLJAN<br>MUNICIPALITY OF LIPJAN |

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 30.07. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

# VENDIM
## PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

### Neni 1
### Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-32604 i datës 30.07.2020 në vazhdim të tekstit: Komisioni) formohet në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
2.Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
3. Majlinda Sylejmani nga subjektet politike
4.Nazmi Krasniqi nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

### Neni 2
### Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

**Neni 3**
**Mandati i anëtarëve**

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 463-32 604 të datës 30.07.2020.

**Neni 4**
**Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dipozitave tjera të akteve nënligjore që do të derivojnë nga Ligji.

**Neni 5**
**Punët administrative - juridike të Komisionit**

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

**Neni 6**
**Kompenzimi i punës së Komisionit**

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Neni 7**
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr.15- 463-32605
Lipjan, më 30. 07. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit,
Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 11-03 2021 | |
|---|---|---|
| Njesia Jedinica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 1-463 | 14010 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, neneve 14 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-463-32604, të datës; 30.07.2020 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës Nr.15-463-32605, të dates; 30.07.2020, në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

## NJOFTIM PUBLIK
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463-32604 të datës 30.07.2020 dhe Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si vijon:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

**Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro), për çdo parcelë kadastrale të**

**ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet pliko ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet ---- Zona Kadastrale, Babush i Muhaxherëve ----.**

**Njoftohen aplikuesit, se hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 29.03.2021, duke filluar në ora 10:00.**

---

**Kriteret për zgjedhjen e ofertave**

Zgjedhja e ofertës më të favorshme për Komunën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

1. Vlera e investimit;

2. Numri i të punësuarve nga investimi;

3. Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për komunën;

4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;

5. Qarkullimi bankar për 3 vitet e fundit;

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Kuverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit për Njoftimin publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.2 në formën fizike, dhe në formë elektronike nga Uebfaqja e Komunës .

**Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi.**

**Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.**

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyrët Nr.106 dhe 107 Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

1.Bekim Shabani ____________
2.Nazim Gashi ____________
3.Majlinda Sylejmani ____________
4.Nazmi Krasniqi ____________
5.Denis Gashi ____________

Me datë:10.03.2021

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| | |
|---|---|
| Pranuar me: Primljeno: | 07.04.2021 |
| Njësia Jedinica / Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 7-463-18415 | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E LIPJANIT**
**OPSHTINA LIPLJAN**
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

| | |
|---|---|
| **DATË/A** | 07.04.2021 |
| **REFERENC-Ë :** | |
| **PËR/ZA/TO:** | Paykos L.L.C. me nr biznessi 810843955, adresa Veternik Zona Industriale-Prishtinë, me pronar Armend Zeqiraj. |
| **NGA/OD/FROM:** | Bekim Shabani, Kryesues i komisionit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës. |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Njoftim |

I/E nderuar,

I. Përmes këtij akti percjellës po ju dergojmë njoftimin për **PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE**, sipas njoftimit publik Nr. 1-463-14010, të datës: 11.03.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, oferta të hapura më datë: 29.03.2021, në Sallën e Kuvendit Komunal në Lipjan.

Shtojcë: **NJOFTIMI PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE**

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 19 par 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-463-32604, të datës; 30.07.2020 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës Nr.15-463-32605, të dates; 30.07.2020, në ZK Babush i Muhaxherëve, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në kohëzgjatje prej nëntdhjetenënt (99) vitesh të pronës së paluajtshme, shpall:

## NJOFTIM
## PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE

I. Të përzgjedhurit nga njoftimi publik 1-463-14010, të datës 11.03.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës janë:

Paykos L.L.C. me nr biznessi 810843955, adresa Veternik Zona Industriale-Prishtinë, me pronar Armend Zeqiraj, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfituese për ngastrat kadastrale si në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

II. Palët e pakënaqura nga procesi i vlerësimet të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit ka të drejtë të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditë kalendarike pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave.

III. Pas përfundimit të afatit për parashtrimin e ankesave, Kuvendi Komunal miraton ofertat e përzgjedhura nga Komisioni Vlerësues.

Bekim Shabani, Kryesues i Komisionit
Nazim Gashi - anëtarë
Nazmi Krasniqi – anëtarë
Denis Gashi – anëtarë

Datë: 07.04.2021

| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVO | KOMUNA E LIPJANIT<br>OPŠTINA LIPLJAN<br>MUNICIPALITY OF LIPJAN |
|---|---|

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 14.04.2021 |
| **Referencë:** | 15-463-19466 |
| **Për:** | - Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal në Lipjan |
| **Cc:** | - Zyrës së Kryetarit të Komunës - Imri Ahmeti<br>- Anëtarët e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit. |
| **Nga:** | Bekim Shabani, kryesues i komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit. |
| **Lënda:** | Raporti i komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës mbi vlerësimin e ofertave të pranuara bazuar në njoftimin publik Nr.1-463-14010. |

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-92 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës zona kadastrale Babush i Muhaxherëve, me Nr-15-463-32604,të datës: 30.07.2020, komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ofron raportin me ofertat e vlerësuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në njoftimin publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës Nr. 1-463-14010, datë 11.03.2021.

Komisioni vlerësues ka zbatuar procedurat për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit, duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-92 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, komisioni vlerësues ka mbajtur takimin për inicimin e procedurave për shpalljen e njoftimit publik Nr. 1-463-14010, të cilin njoftim e ka publikuar dhe është bërë publik në një afat prej pesëmbdhjetë (15) ditëve.

Njoftimi publik ka përmbajtur të dhëna siq vijon: të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin, përshkrimin, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, kriteret, kushtet dhe kufizimit, kohën dhe vendin e hapjës së ankandit publik.

Pronat e shpallura sipas njoftimit të cekur më lartë kanë qenë:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

Më datë 29.03.2021, në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit Komunal, komisioni ka bërë hapjën e ofertave:

1. Bekim Shabani, kryesues
2. Nazmi Krasniqi, anëtarë
3. Denis Gashi, anëtarë
4. Nazim Gashi, anëtarë

Kryesuesi i komisionit ka pyetur anëtarët e komisionit nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit ka konflikt intertesi, dhe i ka pyetur të pranishmit nëse ofertat janë të mbyllura ashtu siq i kanë dorëzuar kur kanë aplikuar, pasi që anëtarët e komisionit janë deklaruar se nuk kanë konflikt interesi, dhe të pranishmit janë deklaruar që ofertat janë të mbyllura ashtu siq i kanë dorëzuar në momentin e aplikimit, komisioni ka hapur në prani të aplikuesve këto oferta:

- Paykos L.L.C adresa veternik zona industrial – Prishtinë, për parcelën si në vijim:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqja m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |

- Paykos L.L.C adresa veternik zona industrial – Prishtinë, për parcelën si në vijim:

| Nr | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqja m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

Pas hapjës së ofertave, komisioni ka informuar aplikuesit se komisioni do ti vlerësoj ofertat me shumë seriozitet maturi dhe duke u bazuar në dispozita ligjore në përpikmëri, njëashtu pas vlerësimit komisioni do të publikoj njoftimin për përzgjedhje e ofertave dhe do të informoj palët e përfshira në këtë proces, më tutje komisioni informoj aplikantët se pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesave, do të procedoj ofertat e përzgjedhura për aprovim në Kuvendin Komunal.

Për dy ditë radhazi më 01.04.2021, dhe më 02.04.2021, komisioni vlerësues është takuar ku ka vlerësuar ofertat një nga një me shumë kujdes në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në njoftim publik Nr. 1-463-14010, datë 11.03.2021.

Vlenë të theksohet se për të dy parcelat e publikuara ka aplikuar vetëm një ofertues, dhe nuk ka pasur oferues apo të interesuar të tjerë.

Pas vlerësimit të ofertave komisioni vlerësues unanimisht rekomandon përzgjedhjën e Paykos L.L.C si përfituese në njoftimin publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, për pronat-parcelat siq vijon:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00559-4 | Babush i Muhaxherëve | 16132 |
| 2 | P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan | P-71409059-00555-2 | Babush i Muhaxherëve | 3868 |

## A r s y e t i m

1.1 Paykos L.L.C ka paraqitur dokumentacionin e kompletuar, qertefikaten e regjistrimit te biznesit, kopjen e lejenjoftimit, fletpagesat, aplikacionin, Planin e biznesit, ofertën, qarkullimin bankar për vitet e fundit, vërtetimin nga administrata tatimore.

1.2 Nga vlerësimi i dokumentacionit compania e rekomanduar si fituese Paykos L.L.C ka dorëzuar dokumentacionin mjaft të kompletuar dhe i ka përmbushur kriterët e përcaktuara sipas njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

1.3 Paykos L.L.C ka dorëzuar siq vijon: Plani i parashikuar tekniko-investiv 1.856.500€, me shkronja (një milion e tetqind e pesdhjetë e gjashtmijë e pesqind euro), pagesat e taksës për aplikim, numrin e të punësuarve të parashikuar nga 25 punëtor në fazën fillestare ndërsa brenda 2

viteve do të trefishohet(sipas ofertës), gjithashu sipas planit të biznesit të dorëzuar nga ofertuesi fabrika do të jetë ekologjike duke ruajtur ambientin, dhe i gjithë prodhimi është i fokusuar për eksport.

Shtojcë e këtij raporti përfundimtar do të jenë:

1. Njofimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës Nr. 1-463-14010, datë 11.03.2021.
2. Vendimi paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës me nr. Nr-15-463-32604,të datës: 30.07.2020.
3. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtëshme të komunës zona kadastrale Lipjan, me Nr.15-463-32605, datë; 30.07.2020.

Shënim: Të gjitha shkresat tjera të lëndes si dhe ofertat janë të dorëzuar në sektorin për qëshjte pronsoro-juridike.

Sinqerisht!

Takimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin të pronave komunale.

Kabineti i nënkryetarit

02.04.2021, ora 10$^{00}$

Tema e takimit; Vlerësimi i ofertave

Anëtarët e komisionit;

1. Bekim Shabani
2. Nazim Gashi
3. Nazmi Krasniqi
4. Denis Gashi
5. Majlinda Sylejmani - mungoi

Kryesuesi i komisionit Bekim Shabani së bashku me komisionin (anëtarët) bëri vlerësimin e ofertave dokumentacionin e plotësimit në mënyrë detale për parcellen katastrale nr. P-71409059-00555-2 ofertë e parashtruar nga PYKOS LLC me adresë Vetërnik - Prishtinë.

Dokumentacioni:

- fletëpagesa
- Garancioni bankar nga PAYKOS LLC
- Certifikata e biznesit
- Plani i biznesit
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi tatimor.

pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe plotësimeve të ofertave, të ofertuesit PAYKOS LLC në mënyrë strikte, komisioni vlerson se oferta në fjalë është serioze në interes të komunes dhe zhvillimit ekonomik të saj.

Komisioni konstaton në mënyrë unanime nga anëtarët prezent se oferta i plotëson kushtet dhe kriteret sipas shpalljes publike me nr. 1-463-14010 e datës 11.03.2021.

Komisioni rekomandon që kjo ofertë të dërgohet në Kuvendin Komunal si ofertë e përshtatshme për dhënien në shfrytëzim të pronës me nr. P-71409059-05555-2 me sipërfaqe 3868 m² zona kadastrale Kaçanik i Vjetër / i shulaxherëve.

Pas përfundimit të takimit, drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, takimi përfundoi në ora 12:00.

Anëtarët e komisionit:

1. Bekim Shabani - Kryesues - [signature]
2. Nazim Gashi - anëtar [signature]
3. Nazmi Kamberi - anëtar [signature]
4. Denis Gashi - anëtar [signature]

Procesmbajtësi:
Nazmi Kamberi
[signature]

Takim i komisionit për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale

Baballoq i Muhaxherëve
01.04.2021.
Ora e takimit $10^{00}$

Tema e takimit: Vlerësimi i ofertave

Antarët e komisionit

1. Nazim Gashi
2. Nazmi Krasniqi
3. Bekim Shabani
4. Denis Gashi
5. Majlinda Sylejmani eshte pse është ftuar me kohë dhe ftesa i ka shkuar me kohë nuk ka paraqitur arsyetim në mos erdhe në takim.

Kryesuesi i komisionit Bekim Shabani së bashku me antarët e tjerë të komisionit po bënë vlerësimin e dokumentacionit dhe planin biznesit në mënyrë të hollësishme për parcelen kadastrale P-7140-9059-0659-4 oferte e paraqitur nga PAYKOS LLC me adresë Veternik Prishtinë
dokumentacioni:

- flete pagesa
- Qarkullimi bankar nga PAYKOS LLC
- Certifikata e biznesit
- Planin i biznesit
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i tatimeve

Pas shqyrtimit të dokumentacionit
dhe planbiznesit të ofertuesit PAYKOS KC
në mënyrë detale, komisioni vlerson se
oferta në fjalë është serioze dhe e
përshtatshme në interes të rritjes së
vlerës së pronës komunale si dhe zhvillimit
ekonomik të komunës së Lipjanit.
Komisioni konstaton në mënyrë
unanime të anëtarëve prezent që
kjo ofertë i plotëson kushtet dhe
kriteret sipas shpalljes publike
me nr. 1-463-14010 e datës 11.03.2021.
Të njëjtën kohë komisioni
rekomandon që kjo ofertë të deklarohet
në kuvend si ofertë e përshtatshme
për dhënien në shfrytëzim të pronës me
nr. P-71409059-00559-1 me
sipërfaqe 16132 m² zona kadastrale
Babush i Muhaxherëve.

Vendoi z. Dreshi, për Ekonomi dhe Zhvillim
Përfundoi në ora $12^{15}$

Anëtarët e komisionit:

1. Behimi Shabani Kryesues - [signature]
2. Nazmi Krasniqi anëtar - [signature]
3. Nazmi Gashi anëtar - [signature]
4. Denis Gashi anëtar - [signature]

Procesmbajtës: Nazmi Krasniqi
[signature]

Takim i komisionit Komunal për dhënie të pronave të

~~Komunale~~ paluajshme : 1

datë : 10.03.2021. e Mërkurë ora 14:00

Rendi i ditës : 1. Draftimi i njoftimit publik.

- Shqyrtimi dhe analizimi i draftit final të njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.

- Gjatë analizës komisioni u konstatua se duhet bërë disa përmirësime në draftin e pranuar në emailë nga kryesuesi i komisionit.

- Pika e diskutueshme ishte pjesa hyrëse e draftit, ~~...~~ ~~...~~ kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit pika Nr. 4, pjesa monetare kompensimi pika Nr. 4. g e komisioni vendosi që si përfundim u draftua drafti final i cili do të publikohet në ndonjë nga gazetat e përditshme dhe në WEB faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit.

Anëtarët e komisionit prezent:

Bekim Shabani -

Nazim Gashi -

Nazmi Krasiqi -

Denis Gashi -

Takimi përfundoi në ora 15:00 vendi: Zyra e Drejtoratit për zhvillim ekonomik.

Procesmbajtësi - Nazim Gashi

Komisioni per Ekzemin në shqyrtim të tokave në shqyrtim Babushi i Muhaxhe.

Hapja e Ofertave. 29.03.2021

ORA 10:00

Anëtarët e komisionit janë 4

Bekim Shabani [signature]

Nazmi Krasniqi [signature]

Nazim Gashi [signature]

Denis Gashi - [signature]

Në hapje është i pranishëm vetëm PAYCOS LLC, nëpërmjet ...

Ofertuesi N.T.P. YLBERI nuk ka përfaqësues prezent në hapje

Pa vonesë në hapjen e ofertuesit PAYKOS LLC,

Ofertuesi ka konstatuar se nuk është në rregull. Gjithsesi komisioni nuk ka asnjë vërejtje

Hapja e aplikacionit ~~164 94~~ ~~164 94~~ 1-463-164 94

data e ... 25.03.2021 për ngastrën kadastrale P-71409059-
-00555-2 (P-71409059)

Zona kadastrale Babush i Muhaxherëve

Shqyrtimi të dokumentave të aplikacionit

të kërkuara Po,

Oferta

Nr. Biznesit

Vetëm i ad. fabrik.

Eshtë komplet. aplikacioni

Oferta nr. 2 nga PAJKOS LC

Hapja e ofertës

1 - 463 - 16492 data 25.03.

Po parcelën P - 71409059 - 00.

~~4.~~ zona kadastrale Baba mahal.

Fletëpagesën ekn

Certifikatë ne gjendje bujqësore.

Plani i biznesit

Letërnjoftimi Po

Formulari Vetëm fabrikor po

Oferta numër 2 ~~2y~~ 2 ama dokumentet e kompletuar.

Oferta 3 - nga NTP YLBER

i cili nuk ka pjesëmarrës. ne hapjen e ofertave prezent

1 - 463 - 15651 data 19.03.2

N as hapja e ofertës komision

kontributi që oferta është dorëzuar

garancinë sepse që [illegible] shkëputur

të Ofertës kurse kemi në këtë

rast se e kanë dokumentuar nuk

më i papranueshëm në ngarje

e autoritetit publik, duke dërguar

kërkesa të tjera, duke na e

dorëzuar fletëpagesë për

duke na dërguar vetëm e

a dë. Tani gjithë gjatë nga

pas planit biznesi sipas formulës

të aplikuar. Oferta në fillim

e përfaqësuar nga Balazhi Sadiku

ka dorëzuar aplikacion nga forma

e thirrjes publike Worgenbormo-

-men, dhe si përpunim nuk do të

merret në vlerësim tani.

Të përfaqësuar nga kompania "PAJOS" ZC nuk

ka asnjë vërejtje mbi zhvillimin të

procedurës të Ofertës.

Gjithë anëtarë edhe anëtarët e komisionit

nuk kanë vërejtje.

Prezent nga kompania në hapjen të

Ofertave Pajtim Bicaj

Përfundoi Ora 10:42

Procesverbalin

Shkëlqe Sopaj

Hapja e Ofertave për Toka

Babush

Vendi:Salla e Kuvendit Komunal Lipjan

Ora: 10:00

Datë 29.03.2021

Lista e pjesëmarresve në hapje

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Vendlindja | Nr personal I leternjoftimit | e-mail | Kontakt: tel |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pajtim Bicaj | Prishtinë | 1176241469 | pajtimbicaj@gmail.com | 045115511 |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | | | | | |